

Fiscal Changes 2018/ Ndryshimet fiskale 2018

23 October 2018

23 tetor 2018

Income Tax

Important additions and amendments have been made to Law 8438/1998 'On Income Tax in the Republic of Albania', as amended.

The proposed changes add another category of exempt income with regards to personal income tax. This is as follows:

- Exemption from personal income tax from income derived from the transfer of ownership rights of agricultural land by a registered farmer to another farmer, or a natural or legal person who carries out agricultural activity. Also, the transfer of property rights within a family relationship, man, woman or children, through the donation and/or renunciation of property, are excluded when the property derives from compulsory joint ownership acquired under law no. 7501, dated 19.7.1991, "On Land", as amended.

The changes affect the income tax applied by the transfer of ownership, as follows:

- Capital gains realised as a result of the transfer of the right of ownership over immovable property, building, land and agricultural land, is taxed at the rate of 15 %. The exchange of land with a construction site on the basis of an exchange contract does not constitute a moment for calculating any capital gains from the transfer of immovable property.

Additionally:

The tax on gambling, according to article 52/2 of law no. 155/2015, 'On Gambling in the Republic of Albania', amended, is applicable at 15% of the gross income from all gambling categories, including the National Lottery licensed under Law no. 95/2013. The gross income from the game is the remaining amount left to the organizer as the difference between the total amount played by the players in the games of chance and the amount earned from them. Profit tax is calculated in accordance with the provisions of this law.

Tatimi mbi të ardhurat

Shtesa dhe ndryshime të rëndësishme janë bërë në Ligjin 8438/1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ndryshimet e propozuara kanë shtuar një tjetër kategori të të ardhurave të përjashtuara, për sa i përket tatimit mbi të ardhurat personale, si më poshtë:

- Përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale të cilat janë realizuar nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi tokën bujqësore nga një fermer i regjistruar të një fermer tjetër apo një person fizik a juridik që kryen aktivitet bujqësor. Përjashtohen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar.

Ndryshimet prekin tatimin e aplikuar për transferimin e pronësisë, si më poshtë:

- Fitimi kapital i realizuar si rezultat i kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore, tatohet me normën 15%. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme.

Gjithashtu:

Tatimi mbi lojërat e fatit, sipas nenit 52/2, të ligjit nr. 155/2015, "Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, aplikohet me shkallën 15 % mbi të ardhurat bruto nga loja për të gjitha kategoritë e lojërave të fatit, përfshirë Lotarinë Kombëtare të licencuar sipas ligjit nr. 95/2013. E ardhura bruto nga loja është shuma e mbetur organizatorit nga diferenca midis shumës totale të luajtur nga lojtarët në lojërat e fatit dhe shumës së fituar prej tyre. Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

The amendments repeal some conditions regarding the deductibility of expenses:

- The documents used as a basis for justification of expenditure for tax purposes are: tax invoice with VAT, simple tax invoice and any other document compiled and issued in accordance with the instructions of the Minister of Finance, pursuant to the tax legislation.
- For construction and sales activities destined for housing, manufacturing activity, business or service activity, the taxable income of the investor is also accounted for by the proceeds corresponding to the part of the building area that the landowners benefited from in the case of exchange contracts land-surface construction. Estimates of income for the part of the landowner is done in the same way as for the part of the income realised by the investor and is based on the methodology approved by the Council of Ministers regarding the minimum fiscal gain.

Changes in the requirement for the submission of the general assembly decision on profit distribution

- Physical persons are no longer required to submit a general assembly decision on profit distribution. Additionally, failure to submit the general assembly decisions for all other entities will still be subject to a penalty of ALL 10,000, however this will not be calculated on a monthly basis.

These above amendments came into effect on 3 October 2018.

The amendments introduce new revenue bands for CIT purposes:

Current revenue bands and CIT rates			
Bands*	0 – 5	5 - 8	8 or more
CIT rate	0%	5%	15%

*expressed in ALL Million

Amended revenue bands and CIT rates			
Bands*	0 – 5	5 – 14	14 or more
CIT rate	0%	5%	15%

*expressed in ALL Million

Ndryshimet shfuqizojnë disa kushte për sa i përket zbritshmërisë së shpenzimeve:

- Dokumenti i përdorur si bazë për justifikimin e shpenzimit, për efekt tatimor, është: fatura tatimore me TVSH, fatura e thjeshtë tatimore dhe çdo dokument tjetër i përpiluar dhe lëshuar, në përputhje me udhëzimet e Ministrit të Financave, në zbatim të legjislacionit tatimor
- Për veprimtaritë e ndërtimit dhe shitjes me destinacion për strehim, veprimtari prodhuese, veprimtari tregtare ose shërbimi, në të ardhurat e tatueshme të investitorit llogariten edhe të ardhurat që i korrespondojnë pjesës së sipërfaqes së ndërtimit që përfitojnë pronarët e truallit për rastet e kontratave të këmbimit truall-sipërfaqe ndërtimi. Vlerësimi i të ardhurave për pjesën e pronarit të truallit bëhet në të njëjtën mënyrë si për pjesën e të ardhurave të realizuara nga investitori dhe ai bazohet në metodikën e miratuar nga Këshilli i Ministrave lidhur me fitimin minimal fiskal.

Ndryshimet në kërkesën për paraqitjen e vendimit të asamblesë së përgjithshme mbi shpërndarjen e fitimit

- Personave fizikë nuk u kërkohet më të dorëzojnë një vendim të asamblesë së përgjithshme mbi shpërndarjen e fitimit. Përveç kësaj, dështimi për të dorëzuar vendimet e përgjithshme të kuvendit për të gjitha subjektet e tjera do të vazhdojë të jetë subjekt i një ndëshkimi prej 10,000 Lekë, megjithatë kjo nuk do të llogaritet në baza mujore.

Ndryshimet e mësipërme hyjnë në fuqi më 3 tetor 2018.

Ndryshimet krijojnë grupime të reja të të ardhurave për qëllime të Tatimit mbi të Ardhurat e Shoqërive:

Nivelet aktuale të xhiros dhe normat e TF			
Xhiro*	0 – 5	5 - 8	8 ose më shumë
Norma TF	0%	5%	15%

*shprehura ne Milion Lek

Nivelet e ndryshuara të xhiros dhe normat e TF			
Xhiro*	0 – 5	5 – 14	14 ose më shumë
Norma TF	0%	5%	15%

*shprehura ne Milion Lek

For entities that carry out activities certified as ‘agro tourism’, according to the legislation in force in the field of tourism, the rate of profit tax is 5%. This rate applies to a 10-year period for legal entities benefiting from the status of ‘certified agro-tourism entity’ until 31 December 2021. The reduced rate application begins in the following tax year after obtaining the status ‘certified agritourism subject’.

The above amendments on the new revenue bands enter into force on 1 January 2019.

(Source: Law No. 39/2018 ‘On some amendments and additions to Law No. 84/1998, ‘On Income Tax in the Republic of Albania’, as amended’, Official Gazette No. 134 and No. 135, published on 18 and 19 September 2018 respectively.)

Për subjektet, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit, shkalla e tatimit mbi fitimin është 5 %. Kjo shkallë aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për personat juridikë që përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi”, deri më 31 dhjetor 2021. Aplikimi i shkallës së reduktuar fillon në vitin tatimor pasardhës, pas përfitimit të statusit “subjekt i certifikuar agroturizmi”.

Ndryshimet e mësipërme në lidhje me nivelet e xhiros hyjnë në fuqi në 1 Janar 2019.

[Burimi: Ligji Nr. 39/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8438/1998 "Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", Fletorja Zyrtare Nr. 134 dhe Nr. 135, botuar më 18 dhe 19 Shtator 2018 respektivisht.]

Let's talk

For a deeper discussion of how these issues might affect your business, please contact:

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700
Email: pwc.albania@al.pwc.com
Web: www.pwc.com/al

Loreta Peçi
Country Managing Partner
Tax and Legal Services

loreta.peci@al.pwc.com

Lorena Gega
Senior Tax Manager
Tax and Legal Services

lorena.gega@al.pwc.com

The material contained in this publication is provided for general information purposes only and does not contain a comprehensive analysis of each item described. Before taking (or not taking) any action readers should seek professional advice specific to their situation. No liability is accepted for acts or omissions taken in reliance upon the contents of this publication.

© 2018 PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k. All rights reserved. PwC refers to the PwC network and/or one or more of its member firms, each of which is a separate legal entity. Please see pwc.com/structure for further details.